

UDHËZIM Nr. 27,

datë 30.7.2018

**PËR FORMATET DHE PROCEDURAT KURRIKULARE TË ARSIMIT DHE
FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 19, pika 2, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Kurrikulat janë dokumente që përmbajnë udhëzimet thelbësore, mbi bazën e të cilave ndërtohet procesi mësimor në arsimin dhe formimin profesional (AFP).
2. Kurrikulat e arsimit dhe formimit profesional publik strukturohen në dy nivele:
 - a) Programe (kurrikula) kombëtare në nivelin qendror të AFP-së; dhe
 - b) Programe (kurrikula) në nivelin e ofruesit të AFP-së.
3. Kurrikulat e nivelit qendror në arsimin profesional publik janë kurrikulat kombëtare të kualifikimeve profesionale të niveleve 2–5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).
4. Kurrikulat e nivelit qendror në formimin profesional publik janë “programet e kurseve të unifikuara”.
5. Kurrikulat kombëtare (skelet-kurrikulat) për kualifikimet profesionale të niveleve 2–5 të KSHK-së hartohen dhe rishikohen nga AKAFPK-ja dhe miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.
6. Lista e kurrikulave kombëtare të arsimin profesional publik i referohet listës së kualifikimeve profesionale të niveleve 2–5 të përfshira në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale.
7. Lista e programeve të kurseve të unifikuara duke përfshirë kohëzgjatjet e tyre, hartohet nga AKAFPK-ja dhe miratohet nga ministri përgjegjës për AFP-në.
8. Kurrikulat kombëtare të kualifikimeve profesionale të niveleve 2–5 të KSHK-së dhe programet e kurseve të unifikuara, pas miratimit nga ministri përgjegjës për AFP-në, publikohen në faqen e internetit të AKAFPK-së.
9. Formatet e kurrikulave kombëtare të arsimit profesional publik dhe kurseve të unifikuara të formimit profesional publik, si dhe rubrikat që ato përmbajnë përcaktohen nga AKAFPK-ja.

10. Formati i kurrikulave kombëtare të arsimit profesional publik përmban edhe listën e lëndëve të kulturës së përgjithshme dhe shpërndarjen kohore sipas viteve shkollore.

11. AKAFPK-ja harton dhe rishikon kurrikulat kombëtare të kualifikimeve profesionale dhe programet e kurseve të unifikuara të AFP-së publike sipas një metodologjie që merr në konsideratë standardet e profesioneve/përshkrimet e profesioneve, standardet e kualifikimeve, si dhe faktorë të tjerë që lidhen me grupin e synuar, kushtet dhe procesin e të nxënës.

12. Për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave kombëtare të kualifikimeve profesionale dhe programeve të kurseve të unifikuara të AFP-së publike, AKAFPK-ja angazhon grupe pune me bashkëpunëtorë të jashtëm (ekspertë të profesioneve dhe të mësimdhënies), të përzgjedhur pas një konkurrimi të hapur.

13. AKAFPK-ja rishikon kurrikulat kombëtare të kualifikimeve profesionale dhe programet e kurseve të unifikuara kur ndryshojnë standardet e profesioneve, standardet e kualifikimeve, kushtet mësimore, si dhe faktorët e tjerë.

14. AKAFPK-ja mbështet procesin e zhvillimit të mëtejshëm dhe të zbatimit të kurrikulave kombëtare të kualifikimeve profesionale dhe programeve të kurseve të unifikuara nga ofruesit publikë të AFP-së.

15. Kurrikulat në nivel ofruesi në AFP publik janë “planet e mësimdhënies”, të cilat zhvillojnë më tej, detajojnë dhe përshtatin kurrikulat e nivelit qendror.

16. Planet e mësimdhënies hartohen dhe rishikohen nga mësimdhënësit të mbështetur nga njësia e zhvillimit e ofruesit dhe miratohen nga drejtori i ofruesit publik të AFP-së.

17. Formati i planit të mësimdhënies, si dhe rubrikat që përmban, rekomandohen nga AKAFPK-ja dhe miratohen nga drejtuesi i ofruesit publik të AFP-së.

18. Ofruesit publikë të formimit profesional, përveç kurseve të unifikuara, mund të ofrojnë edhe kurse të tjera për qëllime dhe nevoja të veçanta, me programe të përgatitura dhe të miratuara nga drejtori i ofruesit.

19. Ngarkohet njësia përgjegjëse e AFP-së në ministrinë përgjegjëse për AFP-në, AKAFPK-në dhe ofruesit publikë të AFP-së për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Arben Ahmetaj